

## SHTYLLA III: SUNDIMI I LIGJIT

### II. MBROJTJA, RESPEKTIMI DHE MEKANIZMAT GARANTUES TË TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT

#### II. B MBROJTJA, RESPEKTIMI DHE MEKANIZMAT GARANTUES TË SË DREJTËS SË INFORMIMIT DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

*(Përmbledhje ekzekutive)*

*E drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale*, si dy të drejta themelore të individit, sanksionohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, konkretisht në nenet 23 dhe 35 të saj. *E drejta për informim* vepron si parakusht për një qeverisje të hapur, që garanton transparencë dhe llogaridhënie. Nga ana tjetër, mbrojtja e të dhënave personale përfaqëson një aspekt tejet të rëndësishëm, si për aktivitetin e shoqërive tregtare, ashtu edhe për sektorin publik dhe për individët, sidomos duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike dhe digjitalizimin e shërbimeve.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDMDHP) është krijuar në vitin 2008 me miratimin e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” si një detyrim i shtetit shqiptar nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit me Bashkimin Evropian. Me miratimin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisionerit iu ngarkua gjithashtu kompetenca e mbikëqyrjes dhe monitorimit të këtij ligji. Korniza ligjore që rregullon fushat e përgjegjësisë, kompetencat dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit, mbështetet në akte kombëtare dhe ato ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë. *Ky kuadër është konsoliduar dhe zgjeruar ndër vite, duke rritur si peshën e autoritetit në arkitekturën institucionale të vendit, ashtu edhe vetëdijen e përgjegjshmërinë së institucionit* për rolin thelbësor që ka në shoqëri për garantimin e dy të drejtave themelore.

*Aktualisht, legjislacioni shqiptar për të drejtën e informimit përmban standardet më të larta ndërkombëtare.* Shteti shqiptar është në vitin e dhjetë të zbatimit të tij dhe vërehen zhvillime të konsiderueshme, si në spektrin e detyrimeve të autoriteteve publike për të qenë transparente, ashtu edhe në atë të ndërgjegjësimit të shoqërisë civile, gazetarëve, qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit. Nxitur nga detyrimet që burojnë në kuadër të integritimit evropian të vendit, por gjithashtu diktuar edhe nga zhvillimet teknologjike, Zyra e Komisionerit ka patur një rol aktiv në përafrimin e legjislacionit për të dy fushat e përgjegjësisë me aktet ndërkombëtare të fushës. Në këtë kuadër përmendim: *Ratifikimin e Konventës 108+ të KiE: Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” (Konventa 108), ratifikimi i*

*Konventës 205 të KiE: Konventa e KiE-së “Mbi aksesin në dokumente zyrtare” (njohur ndryshe si Konventa 205).*

Për t’iu përgjigjur sfidave të zhvillimit ekonomik e shoqëror, e sidomos atyre teknologjike, në përmbushje të rekomandimeve të adresuara ndër vite nga dokumente ndërkombëtare, u miratua ligji nr. 49/2022, datë 12.05.2022, *“Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”.*

*Gjithashtu, me miratimin e ligjit nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, u finalizua një proces disa-vjeçar konsultimi me qytetarë, shoqërinë civile, grupet e interesit dhe autoritete publike që adresuan problematikat e konstatuara përgjatë periudhës së zbatimit të këtij ligji, duke standardizuar akoma edhe më mirë ushtrimin në praktikë të së drejtës për informim.*

Në të njëjtën kohë, hartimi i *projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” synon të përafrojë kuarin ligjor shqiptar me acquis me qëllim që t’u garantojë qytetarëve shqiptarë të njëjtat standarde të larta për mbrojtjen e të dhënave personale.*

***Të dhënat e hapura*** mbështesin dhe inkurajojnë novacionin dhe rrisin përgjegjshmëri, duke përmirësuar demokracinë. Në këtë frymë, u miratua me VKM nr. 147/2015, dokumenti i politikës për të dhënat e hapura, si dhe është në funksion portali <http://opendata.gov.al/>, përdorimi i të cilit është në rritje. Në vijim të këtij procesi u miratua *ligji nr. 33/2022, datë 31.03.2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i cili transponon Direktivën e Bashkimit Evropian nr. 2019/1024 me të njëjtën emërtesë.* Ky ligj hyri në fuqi në prill të vitit 2023 dhe plotëson kuadrin rregullator të fushës të së drejtës për informim, nga këndvështrimi i përparimit teknologjik dhe digjitalizimit të shërbimeve. Me hyrjen në fuqi të këtij akti, Zyrës së Komisionerit i shtohet një tjetër kompetencë, duke u bërë institucioni përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtës për ripërdorim të dokumenteve, si dhe për procedurën e shqyrtimit të ankesave për moszbatimin e këtij ligji. Për këtë qëllim, në strukturën organike të institucionit funksionon një sektor i dedikuar. KDIDHP në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është angazhuar në procesin e hartimit të akteve nënligjore.

***Kuvendi nëpërmjet “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023”,*** ka vlerësuar rolin e veçantë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në qasjen për forcimin e kulturës së garantimit të standardeve më të larta në ushtrimin në praktikë të së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, në vitin 2022, Zyra e Komisionerit ishte një nga institucionet e pavarura shqiptare të përzgjedhura për auditim në kuadër të Misionit të Vlerësimit të BE-së. Në përfundim të këtij procesi, *Misioni i Vlerësimit solli në vëmendje, rolin thelbësor që ka Zyra e Komisionerit në arkitekturën*

*institucionale shqiptare, e mandatuar për mbikëqyrjen ligjore për garantimin e këtyre dy të drejtave themelore.*

*Në të njëjtën kohë, raporti i SIGMA-s ka nënvizuar se zbatimi i të drejtës për informim renditet në krye të ecurisë së parimeve të Reformës në Administratën Publike për fushën e llogaridhënies. Në raportin e monitorimit të SIGMA për Shqipërinë për vitin 2021, vlera për treguesin “Qasja në informacionin publik” është në rritje, krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të kryer në vitin 2017. Në lidhje me këtë progres, SIGMA ndalet ndër të tjera edhe në rolin e Zyrës së Komisionerit, duke vlerësuar pozitivisht përpjekjet e institucionit në promovimin e transparencës. “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, luan një rol kyç në monitorimin e standardeve të transparencës të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014. Në veçanti, Komisioneri vepron si një organ apelimi, i cili vlerëson mjetet juridike kundër refuzimit të aksesit në informacion ose heshtjes administrative. Në shumicën e rasteve të shqyrtuara nga Komisioneri, aplikantët kanë marrë informacionin e kërkuar gjatë procedimit, i cili jep disa dëshmi të rolit të suksesshëm ndërmjetësues të institucionit. Siç tregon edhe anketa WeBER, një pjesë e madhe e popullsisë vlerëson pozitivisht përpjekjet e këtij institucioni në promovimin e transparencës”.*

Megjithatë, duke marrë në konsideratë arritjet e deritanishme, Komisioni Evropian në raportin e Shqyrtimit Analitik për Grup kapituajt e parë “Themelorët” evidenton nevojën që kuadri i ardhshëm legjislativ për aksesin në informacionin publik duhet të forcojë kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale duke parashikuar mekanizma për zbatimin e vendimeve dhe mandatin për të kryer inspektive gjithëpërfshirëse. Po kështu, roli i koordinatorëve për të drejtën e informimit brenda autoriteteve publike duhet të forcohet.

Në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Komisioni Evropian nënvizon si problematika:

- ✓ *“Shqipëria duhet të përafrojë ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR) nr. 2016/679 dhe me Direktivën e Policisë nr. 2016/680;*
- ✓ *Ligji duhet të sigurojë autonominë organizative të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe ta fuqizojë atë të miratojë vendime detyruese;*
- ✓ *Për sa i përket zbatimit të ligjit, kapacitetet dhe kompetencat e Komisionerit, do të duhet të rriten nëse kërkohet që ai të përballojë me efikasitet përgjegjësitë e reja që rrjedhin nga ligji që pritet të miratohet;*
- ✓ *Ndërgjegjësimi për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, si një e drejtë themelore, është ende në nivele të ulëta ndër institucionet publike, si edhe në publikun e gjerë.*

Gjithashtu, referuar Raportit të KE mbi Sundimin e Ligjit (2024), vlerësohet se: “gjithëpërfshirja dhe transparencja e procesit legjislativ në Shqipëri pengohet nga polarizimi politik dhe konsultimi joadekuat publik. Ndarjet e thella politike kanë ndikuar negativisht në

kuadrin legjislativ për mbrojtjen e të dhënave dhe të drejtën e informacionit. Përdorimi i softuerit ndërhyrës të mbikëqyrjes paraqet rreziqe të konsiderueshme për të drejtat themelore, duke përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale dhe lirinë e shprehjes. Mungesa e mekanizmave efektivë të mbikëqyrjes në disa raste ka ngritur shqetësime serioze në lidhje me pajtueshmërinë me standardet e BE-së”. Në të njëjtën kohë, raporti thekson se: “Shqipëria duhet të harmonizojë ligjet dhe praktikatat e saj me legjislacionin e BE-së për mbrojtjen e të dhënave, duke siguruar që masat mbrojtëse për aksesin e të dhënave personale dhe informacionit të jenë të fuqishme dhe efektive. Lidhur me këtë, rishikimi dhe përmirësimi i ligjeve ekzistuese në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe aksesin në informacion nevojitet të bëhet në përputhje me rregulloret dhe praktikatat më të mira të BE-së.

Gjetjet nxjerrin në pah një nevojë urgjente për reforma gjithëpërfshirëse në qasjen e Shqipërisë ndaj mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtës për informacion. Duke adresuar këto sfida dhe duke zbatuar rekomandimet, Shqipëria mund të forcojë themelet e saj demokratike dhe të përafrohet më ngushtë me standardet e BE-së. Dialogu i vazhdueshëm me institucionet e BE-së do të jetë thelbësor në drejtimin efektiv të këtyre reformave.

**Referuar vlerësimit të brendshëm të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, disa nga problematikat kryesore që janë hasur në praktikë nga zyra e Komisionerit, në lidhje me zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit janë:

- Mungesa e dijenisë apo kujdesit të titullarëve dhe autoriteteve për mbarëvajtjen e faqeve zyrtare dhe për rrjedhojë për publikimin e informacionit në Programin e Transparencës.
- Mungesa e ndërgjegjësimit nga ana e administratës për të publikuar në mënyrë proaktive informacionin me karakter publik duke filluar nga jetëshkrimi i drejtuesve/këshilltarëve, legjislacioni i përditësuar, rregulloret, listën e kontratave të nënshkruara dhe deri tek informacioni mbi ofrimin e shërbimeve për qytetarët.
- Mungesa e ndërgjegjësimit në lidhje me kuadrin ligjor për të drejtën e informimit nga ana e zyrtarëve publik të çdo niveli, shoqëruar dhe me neglizhencë. Kjo reflektohet qartë gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit administrativ, ku mbi 70 % e ankesave (nga rreth 1000 të tilla në vit) zgjidhen dhe merret informacioni me fillimin procesit.
- Ndryshim i shpeshtë i koordinatorit, caktimi i tij ose i saj në nivel ekzekutiv, apo të ulët drejtues si dhe kufizim aksesi në strukturat e tjera të Avokatit të Popullit (AP).
- Vonesa që shkaktohen nga ana e drejtuesve të lartë apo strukturave të caktuara, në verifikimin e përgjigjes përfundimtare, e cila sjell shkelje të afateve të përcaktuara në Ligjin për të Drejtën e Informimit për aksesin e informacionit, me kosto të drejtpërdrejtë kjo për transparencën e autoritetit publik, dhe vet titullarit të institucionit.
- Paqartësi nga ana e autoriteteve publike lidhur me konceptin e konfidencialitetit në kontratat publike, trajtuar jo në përputhje me parashikimet e nenit 17 të ligjit (kufizimet).
- Mosrakordimi midis strukturave të AP për përcjelljen në Zyrën e Medias, të kërkesave të gazetarëve, të cilat lidhen me pyetje, intervista, apo prononcime në media të titullarëve. Vetë autoritetet publike duhet të marrin masa organizative për të trajtuar në mënyrë të diferencuar kërkesat për intervista, prononcime apo pyetjet nga gazetarët duke mos ia kaluar për trajtim këto, koordinatorit për të drejtën e informimit pasi nuk kemi të bëjmë

*më informacion publik në kuptim të Ligjit për të Drejtën e Informimit por më informacion që ka interes për publikun dhe duhet të trajtohet jo sipas rregullimeve në Ligjin për të Drejtën e Informimit.*

***Në lidhje me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*** disa nga problematikat kryesore që janë hasur në praktikë nga zyra e Komisionerit janë si më poshtë:

- *Mungesa e rregulloreve specifike për përpunimin, mbledhjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale;*
- *Mungesa e strategjive ose planeve për krijimin e një sistemi të kompletuar për menaxhimin e sigurisë informacionit;*
- *Mungesa e informimit nga ana e kontrolluesve për subjektet e të dhënave mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të tyre (përmes faqes zyrtare, apo formularëve të ndryshëm që aplikojnë, etj.), personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që ata gëzojnë, apo afatin e mbajtjes së të dhënave;*
- *Mungesa e marrjes së masave të duhura nga ana e kontrolluesve për të garantuar konfidencialitetin e të dhënave që përpunohen;*
- *Mungesa e parashikimit të një afati konkret të ruajtjes së të dhënave personale;*
- *Kontrolluesit nuk i kushtojnë vëmendje domosdoshmërisë së trajnimit të vazhdueshëm të nëpunësve/punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese;*
- *Nevojitet një angazhim më rigoroz i kontrolluesve në aspektin e thellimit të njohurive mbi legjislacionin e kësaj fushe, sidomos në kuadër të përafrimit të tij me atë evropian, në mënyrë që të garantohen plotësisht të drejtat e qytetarëve.*

Për të përmirësuar garantimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri, ***është e domosdoshme ndërmarrja e masave të qëndrueshme dhe të koordinuara***, të cilat jo vetëm do të forcojnë institucionet, por do të ofrojnë më shumë siguri dhe transparencë për qytetarët. Një nga hapat më të rëndësishëm në këtë drejtim është ***miratimi i një kuadri të ri rregullator për mbrojtjen e të dhënave personale***, që përfaqëson një moment kyç në procesin e modernizimit të administratës publike dhe përputhjen me *standardet* e Bashkimit Evropian. Ky hap do të kontribuojë ndjeshëm në përmirësimin e standardeve të mbrojtjes së të dhënave dhe sigurisë së informacionit, duke e sjellë ***legjislacionin shqiptar në përputhje me kërkesat ndërkombëtare***. Po ashtu, ***ndryshimet në legjislacionin për të drejtën e informimit do të përmirësojnë transparencën e institucioneve dhe do të rrisin llogaridhënien e administratës publike***.

Një element tjetër kyç për përmirësimin e situatës është ***rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi i publikut dhe kontrolluesve***, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, lidhur me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit. Përmes *fushatave të edukimit dhe trajnimeve të rregullta*, qytetarët dhe institucionet do të jenë më të përgatitur për të përdorur në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme të dhënat personale, ndërsa kontrolluesit do të kenë një njohje më të mirë të përgjegjësive të tyre ligjore. Kjo nismë është e domosdoshme për krijimin e një klime më të

sigurt dhe më transparente në trajtimin e të dhënave personale dhe për të rritur aksesin në informacionin publik.

Me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe zgjerimin e përdorimit të të dhënave digjitale, ***Zyra e Komisionerit ka nevojë për mbështetje të konsiderueshme buxhetore dhe burime njerëzore të specializuara.*** Zhvillimi teknologjik kërkon gjithashtu që institucioni të ketë kapacitete të mjaftueshme për të mbikëqyrur të gjitha proceset e trajtimit të të dhënave në mënyrë efektive. Investimi në *burime të kualifikuara dhe në teknologji të avancuar* do të ndihmojë Zyrën e Komisionerit të ushtrojë funksionet e saj mbikëqyrëse me cilësi të lartë, duke mbuluar të gjitha bizneset dhe institucionet që trajtojnë të dhëna personale. Në të njëjtën linjë, *rritja e masave të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave* është thelbësore për të shmangur rrjedhjet apo keqpërdorimin e informacionit personal të qytetarëve. Me rritjen e përdorimit të shërbimeve digjitale, ekspozimi ndaj rreziqeve është gjithnjë e më i lartë, prandaj investimi në sisteme të sigurt dhe të besueshme është një domosdoshmëri. Ky investim nuk duhet të përqendrohet vetëm në ofrimin e shërbimeve publike, por edhe në *krijimin e mekanizmave të fortë mbrojtës për të dhënat*, të cilat janë të ndjeshme dhe kërkojnë një trajtim të kujdesshëm.

***Monitorimi i rregullt i zbatimit të vendimeve dhe forcimi i funksioneve mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit*** do të sigurojnë që të gjitha subjektet, qofshin ato publike apo private, të respektojnë standardet e kërkuara ligjore. *Përmirësimi i proceseve të auditimit dhe rritja e inspektimeve* do të ndihmojnë në rritjen e transparencës dhe besimit të qytetarëve në institucionet që trajtojnë të dhënat e tyre personale. Kjo është thelbësore për të garantuar mbrojtjen e plotë të të dhënave dhe për të krijuar një mjedis të sigurt për qytetarët.

Hartuar nga Ekspertët e Nivelit të Lartë:

Prof.Asoc.Dr. Nadia Rusi

Dr. Besa Velaj (Tauzi)